

Edukimi dhe zhvillimi i fëmijëve
me nevoja të veçanta nëpërmjet
përdorimit të Teknologjive të
Informacionit dhe Komunikimit
(TIK)

nga

Prof.as.dr.Ardjan Turku
Prof.as.dr.Roland Çerepi
Prof.as.dr.Fatbardha Osmanaga
Dr.Arbona Zhapaj
Dr.Petrit Taraj
Dr.Helena Mukli Grillo
Doc.Neime Pjerro Gjikalaj
Dr.Rina Gera
Msc.Margarita Hido
Dr.Evionda Pylli
Dr.Ermiona Braholli
Msc.Aida Sotiri
Msc.Migena Buzra

Përmbajta

Parathënie	5
1 Barrierat dhe qëndrimet	7
1.1 Ndërveprimi midis dëmtimit dhe barrierave	8
1.1.1 Kategorizimi i barrierave	8
1.1.2 Barrierat qëndrimore	8
1.2 Barrierat qëndrimore në procesin mësimor	15
1.2.1 Reduktimi i barrierave në procesin mësimor	16
1.2.2 Këshilla ndihmëse për trajtimin e rasteve diskriminuese	17
2 Shurdhëria dhe humbja e dëgjimit	19
2.1 Ndërtimi i veshit, dëmtimet dhe përkufizimi i dëmtimit dëgjimor	19
2.2 Anatomia e strukturës dëgjimore dhe të dëgjuarit	19
2.3 Klasifikimi i llojit të humbjes së të dëgjuarit dhe shkaqet e tij	20
2.3.1 Humbjet përçuese	21
2.3.2 Humbjet neurosensoriale	21
2.3.3 Humbjet mikse	21
2.3.4 Çrregullimet qëndrore	22
2.4 Përkufizimi i dëmtimit dëgjimor	22
2.5 Matja dhe klasifikimi i dëmtimit dëgjimor	23
2.5.1 Matja (vlerësimi) i dëmtimit dëgjimor	23
2.6 Klasifikimi i dëmtimit dëgjimor	26
2.7 Mjediset dhe kushtet sfiduese sipas shkallës së humbjes	28
2.8 Humbje e butë deri në të moderuar	28
2.9 Humbje e ashpër deri në të thellë	28
2.10 Afër shurdhërisë apo shurdhërisë së plotë	29
3 Verbëria dhe humbja e shikimit	31
3.1 Kufizimi i shikimit	31
3.2 Përdorimi i procesit SETT dhe udhëzues për vendimmarrje	31
3.2.1 Aftësitë vështirësitë e nxënësve	32

4	Teknologjia ndihmëse	37
4.1	Teknologjia ndihmëse për dëmtimet dëgjimore	39
4.1.1	Humbja e butë deri në të moderuar	39
4.1.2	Dëmtim i moderuar deri në të ashpër	42
4.1.3	Dëmtim i ashpër deri në të thellë	45
4.1.4	Dëmtim i thellë përfshirë shurdhërinë	46
4.1.5	Procesi dhe vendimmarrja për përdorimin e teknologjisë mbështetëse	46
4.2	Teknologji ndihmëse për nxënësit e verbër dhe ata me shikim të dobët	48
5	Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta	49
5.1	Programe kompjuterike	51
5.1.1	Teknologjia asistive për personat me aftësi të kufizuar në dëgjim	53
	Bibliografia	59

Parathënie

Libri “Edukimi dhe zhvillimi i fëmijëve me nevoja të veçanta nëpërmjet përdorimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” është produkt i projektit “Mbështetja e mësuesve të ardhshëm në përdorimin e TIK në edukimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore” mbështetur financiarisht nga “Direct Aid Program Australia” dhe zbatuar nga Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA) dhe Universiteti “Barleti”. Ky libër është hartuar nga pedagogë të Universiteteve të Shkodrës, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Elbasanit, Korçës, të Universitetit “Barleti” dhe ka si qëllim përgatitjen e mësuesve të ardhshëm të 6 universiteteve në Shqipëri në përdorimin e TIK në mësimdhënien me nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Projekti me anë të veprimtarive trajnuese, kërkimore, nëpërmjet diskutimeve dhe reflektimeve, por dhe duke u bazuar te praktikat e mira që u krijuan me studentët e mësuesisë në arsimin fillor dhe ata të masterit në fushën e edukimit në të 7 Fakultetet e Edukimit dhe të Shkencave Sociale të universiteteve pjesëmarrëse, përgjatë viteve 2018-2020, arriti që të sjellë për mësuesit e rinj, por dhe për pedagogët dhe trajnerët e mësuesve të edukimit special këtë material që lehtëson proceset e edukimit dhe të zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, por dhe të fëmijëve me vështirësi të ndryshme në të nxënë me anë të përdorimit të TIK-ut. Libri është i ndërtuar në 5 pjesë që trajtojnë:

1. Barrierat dhe qëndrimet
2. Shurdhëria dhe humbja e dëgjimit
3. Verbëria dhe humbja e shikimit
4. Teknologjia ndihmëse
5. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta

Autorët të librit janë pedagogë të gjithpërfshirjes në arsim, të pedagogjisë speciale, të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit nga 7 universitetet pjesëmarrëse në projekt, të cilët mirëpresin sugjerime, ide dhe mendime për përmirësimin e mëtejshëm të tij, në mënyrë që ky material t’u shërbejë sa më mirë formimit të frytshëm të mësuesve të rinj.

AUTORËT

Termi “fëmijë të veçantë” tashmë është i përdorur gjerësisht jo vetëm në rrethet e specialistëve të fushës së edukimit, por edhe në publik. Ky term përgjithësisht i referohet individëve, të cilët për nga disa karakteristika të dukshme njohëse, shqisore, fizike të sjelljes etj. ndryshojnë, nga ato të standardeve shoqërore apo komunitare të konsideruara si normalitet. Të tilla ndryshime, tek individë të ndryshëm, mund të jenë mbi ose nën këto standarde e për rrjedhojë, këta fëmijë kanë nevojën për programe të veçanta, jo të njëjta me ato të fëmijëve të tjerë, për të përmbushur plotësisht potencialet e tyre. Të tillë fëmijë mund të jenë me aftësi intelektuale superiore apo të talentuar në fusha të caktuara ndërkohë që të tjerë mund të kenë dëmtime të sistemeve a funksioneve trupore (paaftësi të ndryshme) e për rrjedhojë, më shumë se të tjerët, mund të shfaqin problematika në veprimtari a rrethana mjedisore të ndryshme. Termi “i veçantë” është gjithmonë relativ dhe shihet në kontekstin social dhe kulturor përkatës. Të qenit i identifikuar si i veçantë gjithashtu nuk do të thotë se automatikisht nxënësit do t’i duhet edukim special. Shpesh, nevojat arsimore e psiko-sociale të fëmijës mund të gjejnë mbështetje në kushtet e shkollës dhe klasës së zakonshme duke alternuar përshtatjet kurrikulare me strategjitë instruksionale. Përgjithësisht, kur flitet për nevoja të edukimit special, nënkuptohet puna me fëmijët me karakteristika ndën standardet e sipërpërmendura. Kemi klasifikime apo ndarje të ndryshme në kategori, nga një vend në tjetrin apo nga një autor në tjetrin.

Kapitulli 1

Barrierat dhe qëndrimet

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë barrierë çdo ditë, nga pengesat fizike në ndërtesa deri tek pengesat sistemike në punësim dhe programet qytetare. Megjithatë, shpesh, pengesat më të vështira për t'u kapërcyer janë qëndrimet që njerëzit kanë ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara. Pavarësisht se nga e kanë burimin, nga padija, nga frika, keqkuptimi apo nga urrejtja, këto qëndrime bëjnë që njerëzit të mos vlerësojnë dhe të mos provojnë potencialin e plotë që një person me aftësi të kufizuara mund ta arrijë (NCWD/YOUTH, 2020).

Një barrierë është çdo gjë që pengon aksesin e barabartë në; të mirat, shërbimet, informimin e një personi apo të një grupi njerëzish (Sahu K.K., Sahu S., 2015, f.2).

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) i përshkruan barrierat më shumë se sa pengesa fizike.

Përkufizimi i barrierave sipas OBSH-së:

“Faktorët në mjedisin e një personi që, përmes mungesës ose pranisë së tyre, kufizojnë funksionimin dhe krijojnë aftësi të kufizuar. Këto përfshijnë aspekte të tilla, si:

- një mjedis fizik që nuk është i arritshëm (i aksesueshëm)
- mungesa e teknologjisë përkatëse ndihmëse (pajisje ndihmëse, adaptuese dhe rehabilituese),
- qëndrime negative të njerëzve ndaj aftësisë së kufizuar,
- shërbime, sisteme dhe politika që janë ose inekzistente, ose që pengojnë përfshirjen e të gjithë personave me një rrethanë shëndetësore në të gjitha fushat e jetës”(WHO, 2001) (cituar nga CDC, 2019).

1.1 Ndërveprimi midis dëmtimit dhe barrierave

Individi që përballlet me barriera shpesh nuk është pjesëmarrës në jetën aktive shoqërore, jo për faj të tij, por të politikave sociale e infrastrukturore. Prandaj është shoqëria ajo që krijon një situatë paaftësie për personat me aftësi të kufizuara. Kur barrierat në komunitetin e një personi hiqen, ai person me aftësi të kufizuara është në gjendje të marrë pjesë në baza të barabarta me të tjerët. Kjo do të thotë që njerëzit me të njëjtin lloj dëmtimi mund të kenë jetë krejtësisht të ndryshme në varësi të barrierave me të cilat përballen, ku ata jetojnë, çfarë aksesimi kanë në shërbime dhe si i perceptojnë dhe akomodojnë komunitetet e tyre (UNRËA, 2017, f.7).

1.1.1 Kategorizimi i barrierave

Ka disa kategorizime të llojeve të barrierave ndër të cilat përmendim:

1.

qëndrimore,

fizike (përfshirë strukturore dhe komunikuese) dhe
institucionale (UNRWA, 2017, f.6).

2.

Barriera të sjelljes, ku përfshihen sjellje që diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Barriera të informimit e komunikimit, ku përfshihen vështirësitë për të kuptuar një informacion.

Barriera teknologjike, ku teknologjitë nuk mund të modifikohen për të mbështetur pajisjet ndihmëse të kësaj kategorie.

Barriera organizacionale, ku praktikata, procedurat apo politikat e ndryshme organizative diskriminojnë këtë kategori.

Barriera fizike e arkitekturore, ku hapësirat dhe godinat i shkaktojnë vështirësi personave me aftësi të kufizuara

1.1.2 Barrierat qëndrimore

Barrierat qëndrimore janë sjelljet, perceptimet dhe supozimet që diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara. Këto pengesa shpesh lindin nga mungesa e mirëkuptimit, e cila mund t'i bëjë njerëzit të injorojnë, të gjykojnë ose të kenë ide të gabuara për një person me aftësi të kufizuara (The Innovative Design for Accessibility (IDeA), 2020, f.1 dhe Council of Ontario Universities, 2013). Barrierat qëndrimore janë më themeloret dhe kontribuojnë në barrierat e tjera. Shembuj të barrierave qëndrimore përfshijnë:




Figura 1.1:

- Stereotipe: Njerëzit ndonjëherë stereotipojnë ata me aftësi të kufizuara, duke supozuar se cilësia e tyre e jetës është e dobët ose se ata janë jo të shëndetshëm për shkak të dëmtimeve të tyre.
- Stigma, paragjykimi dhe diskriminimi: Këto qëndrime brenda shoqërisë mund të vijnë nga idetë e njerëzve lidhur me aftësinë e kufizuar. Njerëzit mund ta shohin aftësinë e kufizuar si një tragjedi personale, si diçka që duhet të shërohet ose parandalohet, si një dënim për keqbërje, ose si një tregues i mungesës së aftësisë për të vepruar ashtu siç pritej në shoqëri (CDC, 2019). Në vendin tonë, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (LIGJ Nr.10 221, datë 4.2.2010) përcakton si "Diskriminim" çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi" (Neni 3).

Sipas Konventës kundër Diskriminimit në Edukim (1960), termi "diskriminim" përfshin çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preference, e cila duke u bazuar në racën, ngjyrën, seksin, gjuhën, fenë, opinionin politik ose tjetër, në origjinin kombëtar apo social, gjendjen ekonomike apo lindjen, ka për qëllim të ndikojë në zhvleftësimin ose dëmtimin e barazisë së trajtimit në arsim dhe në mënyrë të veçantë:

- (a) në privimin e aksesit në edukim të çdo lloji ose në çdo nivel për çdo individ apo grup individësh;
- (b) kufizimin e çdo individi apo grup individësh në edukimin me një standard të ulët;
- (c) në krijimin ose mbajtjen e sistemeve të ndara arsimore apo të institucioneve për personat ose grupet e personave, në pajtim me dispozitat e nenit 2 të kësaj Konvente;
- (d) në shkaktimin një individi apo një grupi individësh të rrethanave, të cilat nuk pajtohen me dinjitetin e njeriut (cituar nga CSIE, 2018).

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) (2006), në Nenin 5 "Barazia dhe mosdiskriminimi", thekson se: "Shtetet Pjesëmarrëse do të ndalojnë çdo diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe do t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje të barabartë dhe efektive juridike kundër diskriminimit në të gjitha fushat" (pika 2) dhe "Për të promovuar barazinë dhe për të eliminuar diskriminimin, Shtetet Pjesëmarrëse duhet të marrin të gjitha hapat e duhur për të siguruar dhënien e akomodimit të duhur" (pika 3). Konventa e UNESCO-s kundër Diskriminimit në Edukim (2008) dhe traktate të tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ndalojnë çdo formë përjashtimi apo kufizimi në mundësitë për edukim mbi bazën e dallimeve të atribuara apo

të perceptuara të tilla, si: gjinia, origjina etnike, gjuha, besimi fetar, kombësia, origjina sociale, rrethana ekonomike, aftësia, etj. (cituar nga Dapudong, 2014, f.1). Statuti i të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2012) në Nenin 21 “Mosdiskriminimi”, thekson se “ndalohet çdo formë e diskriminimit e bazuar në çfarëdo baze siç është gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, veçoritë gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinioni politik ose ndonjë opinion tjetër, e bazuar në anëtarësimin në një pakicë kombëtare, e bazuar tek prona, lindja, tek aftësia e kufizuar, e bazuar tek mosha apo orientimi seksual” (pika 1). Barrierat qëndrimore, të cilat rezultojnë në stigmatizim dhe diskriminim, u mohojnë personave me aftësi të kufizuara dinjitetin dhe potencialin e tyre dhe përbëjnë një nga pengesat më të mëdha për të arritur barazinë e mundësive dhe integrimin shoqëror. Qëndrimet negative krijojnë një mjedis privues në të gjitha fushat. Shpesh shprehen përmes pamundësisë së personave me zhvillim normal për të parë përtej dëmtimit; përmes diskriminimit; frikës; bullizmit dhe pritshmërive të ulëta për personat me aftësi të kufizuara. Qëndrimet ndaj personave me aftësi të kufizuara në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme mund të jenë më ekstreme dhe shkalla e stigmës dhe e turpit mund të jetë më e lartë sesa në kontekstet me të ardhura të larta (Mont, 2014, f. 24). Këto qëndrime mund të lindin si rezultat i “ideve të gabuara, stereotipeve dhe mitologjisë që e lidhin aftësinë e kufizuar me ndëshkimin për mëkatet e kaluara, me fatkeqësinë ose me magjinë”. Diskriminimi i shumëfishtë dhe ndërsektorial mund të intensifikojë barrierat e qëndrimit. Staf i organizatave të zhvillimit mund të ketë gjithashtu qëndrime negative ndaj personave me aftësi të kufizuara (Bruijn et al., 2012, f. 22) (cituar nga Rohwerder, 2015, f.33). Qëndrimet

Qëndrimet janë të rëndësishme sepse modelojnë perceptimet e individëve lidhur me botën sociale e fizike dhe ndikojnë sjelljet e dukshme. Qëndrimet përkufizohen si mendime (refleksione) me vlera të rrënjësura dhe forcë bindëse që e udhëheqin individin në përzgjedhjen që ai bën për të vepruar e për të reaguar ndaj të tjerëve. Qëndrimet janë shumëdimensionalë dhe përbëhen nga komponentë afektivë, bihejvioralë dhe konjitivë. Komponenti afektiv ka të bëjë me ndjenja dhe reagime emocionale, komponenti bihejvioral lidhet me sjelljen aktuale apo me sjelljen e paramenduar dhe komponenti konjitiv pasqyron besime dhe njohuri. Kjo pikëpamje e popullarizuar nga Milton Rosenberg dhe Carl Hovland në fillimet e viteve 1960 sugjeron se një qëndrim përbëhet nga mënyra se si ne ndihemi, nga çfarë ne mendojmë dhe nga çfarë ne jemi të prirur për të bërë në lidhje me objektin, situatën apo personin për të cilin formojmë një qëndrim. Duke theksuar klasifikimin trepalësh (konjitiv, afektiv, konativ) Eagly dhe Chaiken (1993) i përkufizuan qëndrimet si “tendencë për të vlerësuar një entitet me një shkallë pëlqimi apo mospëlqimi, e shprehur, zakonisht, në përgjigje konjitive, afektive dhe bihejviorale”. Siç tregohet nga ky përkufizim, qëndrimet kanë komponent konjitiv (besime, njohuri, parashikime apo asocime të perceptuara midis objekteve dhe attributeve), komponent afektiv (ndjenja, gjendje shpirtërore, motive, emocione dhe ndryshime fiziologjike bashkëshoqëruese) dhe komponentin e performancës (sjellje apo veprim, të dyja të nënkuptuara dhe aktuale) (McGuire, 1985). Secili prej këtyre tre komponentëve strukturorë mund të shprehet në mënyrën verbale apo joverbale të përgjigjes. Afekti është përdorur

për të përshkruar ndjenja negative dhe pozitive që ka njeriu kundrejt një objekti ndaj të cilit mban një qëndrim të caktuar Konjicioni përdoret për t'iu referuar besimeve që ka njeriu kundrejt një objekti ndaj të cilit mban një qëndrim të caktuar dhe sjellja është përdorur për të përshkruar veprimet dhe përgjigjet e dukshme kundrejt një objekti ndaj të cilit mban një qëndrim të caktuar Në kontekstin e perceptimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, komponenti afektiv i qëndrimeve përfshin thënie lidhur me ndjenjat e individit ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara, të tilla si: "Unë trembem nga një fëmijë me autizëm" Komponenti bihejvioral përfshin thënie më qëllimin për të ndërvepruar me një fëmijë me aftësi të kufizuara, shpesh të referuara si qëllime bihejviorale apo qëndrime konative Një shembull i tillë është "Unë do t'i ndaja lodrat e mia me një fëmijë me autizëm". Dimensioi konjitiv i qëndrimeve përfshin thënie lidhur me bindjen rreth një fëmije me aftësi të kufizuara, të tilla si "Fëmijët me autizëm janë të mirë në sporte" Shumë kërkime mbështesin idenë që informimi i individëve lidhur me aftësitë e kufizuara ka një ndikim të rëndësishëm në qëndrimet ndaj Aftësisë së Kufizuar. Ky informim është produkt i kontaktit të mëparshëm me persona me Aftësi të Kufizuara, produkt i efekteve të edukimit dhe i ekspozimit përmes burimeve të medias (mjeteve të komunikimit masiv). Mënyra sipas së cilës paraqitet informacioni mbi Aftësinë e Kufizuar ndikon në faktin nëse ky informacion promovon qëndrime favorizuese apo jofavorizuese (McCaughey, 2009, f.16). Stigma

Disa nga përkufizimet mbi stigmën janë: Shoqata Kanadeze e Shëndetit Mendor, e cila përkufizon stigmën në lidhje me besimet apo qëndrimet negative ndaj njerëzve, të cilët perceptohen si të ndryshëm. Sipas *Zartaloudi&Madianos*, stigma përkufizohet si "Efekti negativ i një etiketimi dhe produkt turpi, gjë që e veçon individin nga të tjerët" Nivelet e stigmës

Ilustrimi i konstruksioneve që mundësojnë formimin e stigmës na ndihmon të kuptojmë tre nivele specifike të stigmës: stigma sociale, vetëstigma dhe stigma profesionale. Në këtë kontekst, "nivelet" nuk i referohen një hierarkie me rëndësi për këto stigma të larmishme, por përkundrazi, përfaqësojnë fusha të ndryshme shoqërore të stigmës që mund të dallohen nga njëra-tjetra. Së pari, qëndrimet dhe besimet e stigmatizuara ndaj individëve me çrregullime të shëndetit mendor dhe çrregullime të përdorimit të drogës janë shpesh në formën e stigmës sociale, e cila është e pranishme tek publiku i gjerë. Së dyti, stigma sociale, apo edhe perceptimi se stigma sociale ekziston, mund të brendësohet nga një person, duke rezultuar në atë që shpesh quhet vetëstigmatizim. Së fundmi, një nivel tjetër i stigmës më pak i studiuar është ai që zhvillohet tek profesionistët e shëndetit ndaj klientëve të tyre. Meqenëse profesionistët e shëndetit janë pjesë e publikut të gjerë, qëndrimet e tyre pjesërisht mund të pasqyrojnë stigmën sociale; megjithatë, rolet dhe përgjegjësia e tyre unike për "ndihmë" mund të krijojnë një barrierë specifike (Ahmedani, 2011, f.4). Ekzistojnë një sërë konstruktesh të dallueshme që përmbajnë stigmën. Këto përfshijnë stereotipin, paragjykimin dhe diskriminim. Një stereotip është një besim i mbajtur nga një grup i caktuar njerëzish. Për shembull, besimi se të gjithë njerëzit me një sëmundje mendore të diagnostikuar janë të rrezikshëm është një stereotip. Paragjykimi është në harmoni me stereotipin e që rezulton në një reagim emocional negativ (Corri-

gan, 2004) Më tej, paragjykimi është përkufizuar si një opinion i pafavorshëm i formuar pa baza të drejta ose duke mos pasur njohuri të mjaftueshme (Web site :www. merriam- webster.com.) Një shembull paragjykimi mund të jetë të pranuarit se personat me sëmundje mendore janë me të vërtetë të rrezikshëm, duke shkaktuar një reagim emocional, siç është frika ose zemërimi. Diskriminimi është përgjigja sjellore ndaj paragjykimit, e cila mund të përfshijë, shmangien e një personi me sëmundje mendore për shkak të frikës nga paragjykimi dhe për shkak të besimit se personi është i rrezikshëm Hulumtimet në lidhje me qëndrimet ndaj personave me aftësi të kufizuara tregojnë se shumë njerëz mbajnë qëndrime negative dhe se këto qëndrime përbëjnë pengesa për barazinë e personave me aftësi të kufizuara (Deal, 2007). Të rinjtë dhe njerëzit me më shumë arsimim priren të kenë qëndrime më pozitive ndaj personave me aftësi të kufizuara. Qëndrimet negative mund të vijnë nga perceptimet e gabuara, mungesa e vetëdijes ose mungesa e njohurive dhe mund të manifestohen në etiketime të drejtpërdrejta apo në diskriminim të drejtpërdrejtë ose indirekt (Deal 2007) Në shumë shoqëri, të jetuarit me aftësinë e kufizuar shoqërohet me turp, frikë dhe/ose mëshirë, duke çuar lehtësisht në izolim ose mbimbrotje (Guzmán et al. f.8). Një nga pengesat më serioze që has një person me aftësi të kufizuara ka të bëjë me konceptet e gabuara dhe qëndrimet negative në lidhje me aftësinë e kufizuar. Këto pengesa të shkaktuara nga shoqëria shpesh përbëjnë një sfidë shumë më të madhe, sesa dëmtimi i personit. Individët me lloje të caktuara të aftësive të kufizuara, siç janë aftësia e kufizuar intelektuale, aftësi të kufizuara psiko-sociale/mendore, shpesh janë më të prekurit (ILO, 2009). Suksesi i aftësisë së një personi me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në botën e punës varet kryesisht nga arsimit, trajnimit, akomodimi i arsyeshëm i nevojave dhe mundësive të tyre sesa dëmtimi i tyre (ILO, 2009). Akomodimi i arsyeshëm për nevojat e personave me aftësi të kufizuara kryhet shumë rrallë. (ILO, Geneva). Sipas Nenit 2 të Konventës për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara (cituar nga Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO), Gjenevë), akomodimi i arsyeshëm përkufizohet si "...modifikimi i nevojshëm dhe i duhur dhe rregullimet, të cilat nuk imponojnë një ngarkesë joproporcionale ose të panevojshme, kur është e nevojshme në një rast të veçantë, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara kënaqësi ose ushtrimin në një bazë të barabartë me të tjerët të të gjitha të drejtave njerëzore dhe liritë themelore;" (cituar nga ILO, Geneva, f.3). Sipas përkufizimit, barrierat sociale mund të kuptohen si fenomene të shkaktuara nga qëndrimet e njerëzve intolerantë, të cilat nëse nuk korrigjohen, mund të jenë pengesë kryesore për pjesëmarrjen e një personi në aktivitetet e shkolles. Barrierat sociale burojnë nga qëndrimet njerëzore ndaj Baine (1991) i quan ato **barriera qëndrimore**. Kontaktet e bazuar tek përvoja me personat me aftësi të kufizuara kanë treguar se qëndrimet shoqërore imponojnë pengesën më të madhe për personat me ndonjë formë të aftësisë së kufizuar (Ishmael, 2015, f.62-63).

Format kryesore të barrierave qëndrimore

Personat me aftësi të kufizuara përballen me forma të ndryshme të barrierave qëndrimore.

- **Inferioriteti.** Për shkak se një person mund të jetë i dëmtuar në një nga funksionet kryesore të jetës, disa njerëz besojnë se individit është një "qytetar i klasit të dytë".
- **Keqardhja.** Njerëzit ndiejnë keqardhje për personin me aftësi të kufizuara, i cili tenton të çojë në sjellje mbrojtëse. Personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi nuk duan keqardhje dhe bamirësi, thjesht mundësi të barabarta për të gjetur rrugën e tyre dhe për të jetuar të pavarur.
- **Adhurimi i heroit.** Njerëzit e konsiderojnë dikë me aftësi të kufizuara që jeton në mënyrë të pavarur ose ndjek një profesion si trim ose "special" për tejkalimin e aftësisë së kufizuar. Por shumica e personave me aftësi të kufizuara nuk duan tituj akordime emërtime për kryerjen e detyrave të përditshme. Aftësia e kufizuar është aty; individit thjesht ka mësuar të adaptohet duke përdorur aftësitë dhe njohuritë e tij, ashtu si të gjithë përshtaten për të qenë i gjatë, i shkurtër, i fortë, i shpejtë, i thjeshtë, tullac, bjond, etj.
- **Mungesa e njohurive.** Personat me aftësi të kufizuara shpesh shihen si të paaftë për të përmbushur një detyrë nëse nuk i shfaqin aftësitë e tyre. Në fakt, njerëzit me kuatriplegji mund të drejtojnë makina dhe të kenë fëmijë. Njerëzit që janë të verbër mund ta tregojnë kohën në orë dhe të vizitojnë. Njerëzit që janë të shurdhër mund të luajnë basketboll dhe mund të shijojnë muzikë. Personat me aftësi të kufizuara zhvillimore mund të jenë krijues dhe të mbajnë etikë të fortë pune.
- **Efekti i Përhapjes.** Njerëzit supozojnë se aftësia e kufizuar e një individit ndikon negativisht në shqisat, aftësitë ose tiparet e personalitetit, ose se personi në përgjithësi, është i dëmtuar. Për shembull, shumë njerëz shfaqin emocion të fortë ndaj njerëzve të verbër ose nuk presin që njerëzit që përdorin karriget me rrota të kenë inteligjencën për të folur vetë. Fokusimi tek aftësitë e personit sesa tek aftësia e kufizuar e tij e sfidon këtë lloj paragjykimi.
- **Stereotipet.** Ana tjetër e efektit të përhapjes ka të bëjë me përgjithësimet pozitive dhe negative që njerëzit formojnë rreth aftësive të kufizuara. Për shembull, shumë besojnë se të gjithë njerëzit që janë të verbër janë muzikantë të shkëlqyer ose kanë një ndjesi më të mprehtë të nuhatjes dhe dëgjimit, se të gjithë njerëzit që përdorin karriget me rrota janë të shkathët apo garojnë në lojërat olimpike, se të gjithë njerëzit me aftësi të kufizuara zhvillimore janë të pafajshëm dhe me natyrë të ëmbël, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara janë të trishtuar dhe jo të pëlqyeshëm. Përveç se reduktojnë aftësitë e individit, paragjykime të tilla mund të vendosin një standard shumë të lartë ose shumë të ulët për individët që janë thjesht njerëzorë.
- **Reagimi.** Shumë njerëz besojnë se individëve me aftësi të kufizuara u jepen përparësi të padrejta, siç janë kërkesat më të lehta për punë. Punëd-

hënësit duhet të kenë për personat me aftësi të kufizuara të njëjtat standarde të punës si punëtorët e tjerë, megjithëse mjetet për përmbushjen e detyrave mund të ndryshojnë nga personi në person. Akti për Amerikanët me Aftësi të Kufizuara (ADA) (The Americans with Disabilities Act) nuk kërkon privilegje të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, thjesht mundësi të barabarta.

- **Frika.** Shumë njerëz kanë frikë se “mund të bëjnë ose mund të thonë gjënë e gabuar” rreth dikujt me aftësi të kufizuara. Prandaj, ata e evitojnë shqetësimin e tyre duke e shmangur një individ me aftësi të kufizuara. Ashtu si me takimin e një personi nga një kulturë tjetër, takimet e shpeshta mund të rrisin nivelin e komfortit e rehatisë

Parashtrim me shembuj të ndërveprimit të barrierave

- Nervat pamore të Yasinit dhjetëvjeçar janë dëmtuar plotësisht (dëmtim) për shkak të një sëmundjeje në sy dhe ai ka vështirësi në shikim (vështirësi në funksionim). Shkolla e tij nuk pranon ta marrë atë përsëri, pasi nuk ka burime për të mbështetur një fëmijë me dëmtim të shikimit (qëndrimi i stafit të shkollës - barrierë). Nuk ka shkolla të tjera në komunitetin e tij dhe, si rrjedhojë, Yasin nuk mund të frekuentojë shkollën (aftësi e kufizuar/situatë privuese).
- Për shkak të një aksidenti në komunikacionin rrugor Razia pësoi një dëmtim të palcës kurrizore (dëmtim), gjë që rezultoi që ajo të mos ishte në gjendje të ecë si më parë (vështirësi në funksionim) dhe ajo filloi të përdorë karrocë. Ajo dëshiron të vazhdojë kursin e saj të formimit profesional pas aksidentit, por qendra e formimit profesional është në katin e parë të një ndërtese publike pa rampa dhe vetëm shkallë (ambient i ndërtuar - pengesë). Prandaj, ajo nuk është në gjendje të përfundojë arsimin e saj profesional (aftësi e kufizuar/situatë privuese).
- Ibrahim i lindi me sindromën Daun (dëmtim), gjë që ndikoi në aftësinë e tij për të kuptuar, mësuar dhe mbajtur mend (vështirësi në funksionim). Ai, gjithashtu, kishte vështirësi në ecje (vështirësi në funksionim), pasi është i prekur drejtqëndrimi i tij. Prindërit e tij kurrë nuk e regjistruan atë në shkollë (aftësi e kufizuar/situatë privuese), pasi ata nuk menduan se kishte kuptim edukimi i tij dhe ata, gjithashtu, kishin frikë se ai do të ngacmohej (qëndrimi i prindërve - pengesë) (UNRWA, 2017, f.7).

1.2 Barrierat qëndrimore në procesin mësimor

Fëmijët me aftësi të kufizuara përjetojnë diskriminim dhe përjashtim social në çdo aspekt të jetës së tyre. Kjo për pasojë të ndikimit të kombinuar të refuzimit të ndryshimeve, të varfërisë, izolimit shoqëror, paragjytimeve, padijes dhe mungesës së shërbimeve dhe mbështetjes (UNICEF, 2013, f.10). Sipas Diamond dhe Kesinger (2002), të kuptuarit e rrethanave të aftësive të kufizuara

nga ana e fëmijëve pa Aftësi të Kufizuara ushtron ndikim në faktin nëse ata i përfshijnë fëmijët me Aftësi të Kufizuara në grupet e tyre të moshatarëve (Dyson, 2005). Vazhdon të ketë diskutim të konsiderueshëm të potencialit të edukimit, veçanërisht të edukimit me fëmijët e vegjël, për të sjellë ndryshimin social “Fëmijët nuk janë lindur me paragjykime kundrejt njerëzve që kanë aftësi të kufizuara, por i fitojnë ato nga të rriturit, nga media dhe mënyra se si është organizuar shoqëria në përgjithësi” Megjithatë, edhe tek moshat shumë të vogla, fëmijët shfaqin preferenca kulturore të brendësuar apo paragjykime Barrierat qëndrore kanë të bëjnë me besimet dhe qëndrimet që mësuesit mund të kenë në lidhje me shërbimet arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe akomodimin e nxënësve në mjedisin e arsimit të përgjithshëm, ndërveprimet me prindërit dhe kujdestarët dhe pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet shkollore dhe në komunitet. Qëndrimet e nxënësve që nuk kanë aftësi të kufizuara ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara mund të jenë një reflektim i qëndrimeve të modeluara nga mësuesi. Qëndrimet negative mund të vijnë nga mungesa e informacionit, keqinformimi, përvojat e mëparshme ose situatat e vështira që mbeten të pazgjdhura ose të pasuksesshme. Mësuesit mund të kenë ide të gabuara lidhur me punën me nxënës me aftësi të kufizuara, ose mund të kenë frikë se nuk do të jenë mësues efikasë në një mjedis gjithëpërfshirës. Mësuesit, gjithashtu, mund të shqetësohen se si përfshirja do të ndikojë në klimën e klasës dhe edukimin e nxënësve që nuk kanë aftësi të kufizuara. Përfshirja kërkon mënyra të reja të të menduarit rreth mësimdhënies, qasje të reja në komunikim dhe bashkëpunim dhe qëndrime të reja rreth praktikave të shëndetshme arsimore (Darrow, 2009, f.30). Tashmë pranohet gjerësisht se besimet dhe qëndrimet e mësuesve në lidhje me nxënësit me nevoja të veçanta kanë ndikim shumë të fuqishëm në pritshmëritë e tyre për progresin e fëmijëve të tillë në shkollat e zakonshme Madje, është argumentuar se integrimi i suksesshëm është i mundur vetëm kur mësuesit shfaqin qëndrime të arsyeshme dhe pozitive kundrejt nxënësve me nevoja të veçanta dhe kundrejt parimeve kryesore të integritit

1.2.1 Reduktimi i barrierave në procesin mësimor

Qëndrimet ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara janë të lidhura me njohuritë dhe me përvojat e nxënësve Kërkues të ndryshëm kanë vënë në dukje që përvojat e hershme pozitive dhe kontakti social mes fëmijëve pa aftësi të kufizuara dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara promovojnë qëndrime më pozitive Informacioni lidhur me aftësitë dhe cilësitë pozitive të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bile në stadet e hershme të edukimit, mund të ndihmojë në kufizimin e qëndrimeve të mëvonshme negative Ekzistojnë disa mënyra që mund të ndihmojnë mësuesit për heqjen e pengesave qëndrore. P.sh.:

- Shmangia e bërjes së supozimeve në lidhje me aftësinë e kufizuar apo në lidhje me aftësitë e një nxënësi; shumë persona me aftësi të kufizuara pohojnë se frustrohen nga njerëzit që janë duke bërë supozime lidhur me atë se çfarë mund të bëjnë ose nuk mund të bëjnë personat me aftësi të

kufizuara.

- Inkurajimi i nxënësve me aftësi të kufizuara që të mos kenë turp dhe t'u flasin për mënyrën se si mësojnë dhe çfarë mund të jetë “e vështirë” në lëndën tuaj, në klasë apo në mësimdhënien. Mos harroni se nxënësit me aftësi të kufizuara nuk kanë pse t'ua zbulojnë aftësinë e tyre të kufizuar profesorëve të tyre ose kujtdo tjetër, vetëm në mjedisin akademik, në mënyrë që të marrin akomodimet.
- Respektimi i privatësisë së nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Këmbëngulni për sjellje profesionale, qytetare ndërmjet nxënësve për të respektuar dallimet e njerëzve dhe për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës.
- Angazhohuni në procesin e akomodimit dhe zbatoni akomodimin e duhur (Council of Ontario Universities, 2013).

Qëndrimet pozitive mund të zhvillohen dhe përmirësohen në mënyra të ndryshme. Mësuesit inkurajohen të zbulojnë pikat e forta të nxënësve dhe të zhvillojnë metoda mësimore dhe adaptime që bazohen në këto pika të forta. Për më tepër, zhvillimi i marrëdhënieve me nxënës individualë i ndihmon mësuesit që ta bëjnë më humane përvojën dhe të mësojnë për nxënësit, përtej aftësive të kufizuara. Bashkëmoshatarët mund të kenë nevojë për strukturë dhe drejtim nga mësuesi për të rritur socializimin, bashkëveprimin dhe respektin ndaj njëri-tjetrit

1.2.2 Këshilla ndihmëse për trajtimin e rasteve diskriminuese

- Bëjeni rregull që përjashtimi apo gjuha fyese nuk janë të pranueshme dhe diskutojeni këtë me fëmijët në një mënyrë të prekshme dhe joautoritare.
- Kur një fëmijë thotë diçka të dëmshme për një fëmijë tjetër, e cila i referohet ndryshimit, duhet ndërhyrë menjëherë dhe duhet t'i kujtosh rregullin fëmijës duke mundësuar kalimin në biseda të tjera.
- Qetëso fëmijën që ishte objekt diskriminimi dhe ndihmoje atë që të shprehë me fjalë ndjenjat e tij. Po ashtu, mbështete edhe fëmijën që e shkaktoi lëndimin. Fëmijët kanë nevojë të ndihmohen për të njohur çfarë po ndodh dhe kanë nevojë të mësojnë se është një lloj e papranueshme për ta që të jenë të shënjestruar apo që të shënjestrojnë të tjerët.
- Nëse frika apo paragjykimi është arsyeja themelore, përpiku të mësosh më shumë rreth paragjyqimeve të fëmijës dhe bëj një plan me afat të gjatë për ta trajtuar këtë çështje. Një gjë e tillë do të përfshijë diskutimin me familjet dhe me stafin.
- Ndërhyrjet duhen bërë menjëherë dhe do të jetë e nevojshme të pasohen nga fëmijët (Murray et al., 2006, f.13) (cituar nga Osmanaga, 2017, f.100).



Kapitulli 2

Shurdhëria dhe humbja e dëgjimit

2.1 Ndërtimi i veshit, dëmtimet dhe përkufizimi i dëmtimit dëgjimor

2.2 Anatomia e strukturës dëgjimore dhe të dëgjuarit

Struktura (sistemi) e të dëgjuarit është e ndarë në katër pjesë:

- Veshi i jashtëm
- Veshi i mesëm
- Veshi i brendshëm
- Sistemi nervor qendror dëgjimor

Veshi i jashtëm (shih figurën) përbëhet nga llapa e veshit, kanali dhe përfundon në timpanin (daullen) e tij dhe ka për funksion të mbrojë veshin e mesëm, të “kapë” dhe drejtojë tingullin nëpër kanal dhe të përforcojë lokalizimin e tingullit.

Veshi i brendshëm përbëhet nga tre kocka të quajtura “çekiçi,” kudhra” dhe “yzengjia” të trija të lidhura në një sistem. Timpani i veshit është i ngjitur me njerën anë të çekiçit, ky është i “lidhur” me kudhrën, kjo me yzengjinë, siç në fund edhe yzengjia, kocka e tretë dhe më e vogla, është e lidhur me dritaren ovale që është një hapje në veshin e brendshëm, duke krijuar një ansambël funksional. Valët e tingullit të drejtuara nëpër kanalin e veshit bien mbi timpanin (“daullen”) e veshit, duke shkaktuar dridhje (vibrime). Këto vibrime i përcillen sistemit të tre kockave besnikërisht, sistem i cili i përcjell më tej për në veshin e brendshëm. Energjia fizike e valëve të tingullit, përcjellë nga veshi i jashtëm në veshin e mesëm, transformohet aty në energji mekanike. Veshi i brendshëm,




Figura 2.1: Ndërtimi i veshit

siç shihet edhe në figurë, ka formën e një kërmilli apo të kanaleve në formë kërmilli, të mbushur me lëngje. Brenda lëngjeve ka qeliza nervore të vogla floku (qime). Energjia mekanike, nga veshi i mesëm, i përcillet këtij sistemi të veshit të brendshëm duke ngacmuar rreth 20000 qeliza floku apo thënë ndryshe, vibrimet nga valët e tingujve konvertohen nga këto qime në sinjale nervore apo impulse elektrike. Nga këto qeliza zë fill ai që quhet nervi dëgjimor, i cili zgjatet drejtë korteksit dhe futet në zonën që quhet “Brainstem” në sistemin nervor dëgjimor qëndror e ku përcjell këto impulse. Në vazhdim, një numër rrugësh nervore përbërë nga segmente të shkurtëra dhe të gjata krijojnë nervin dëgjimor apo “rrugët e sistemit nervor dëgjimor” të cilat përfundojnë në zonën apo vatrën dëgjimore të korteksit, në pjesën e lobit temporal të trurit, ku bëhet dekodimi i mesazhit të përcjellë nga impulset nervore apo thënë ndryshe, realizohet të dëgjuarit.

2.3 Klasifikimi i llojit të humbjes së të dëgjuarit dhe shkaqet e tij

Klasifikimi, sa i takon llojit të humbjes së të dëgjuarit, është i lidhur me faktin se ku apo në cilën pjesë të sistemit të të dëgjuarit shkaktohet dëmtimi dëgjimor. Në gjithë literaturën, në varësi të vendit ku shkaktohet, përcaktohen katër lloje humbjesh:

1. Humbje përcuese e të dëgjuarit

2. Humbje neurosensoriale e të dëgjuarit
3. Humbje mikse e të dëgjuarit
4. Çrregullime qendrore të të dëgjuarit

2.3.1 Humbjet përçuese

Veshi i jashtëm dhe ai i mesëm garantojnë kapjen, fokusimin dhe transmetimin e tingujve përmes tyre, deri në dritaren ovale të veshit të brendshëm. Funkzioni i tyre, si pjesë e sistemit, është përcimi i tingujve, besnikërisht, në veshin e brendshëm. Çdo dëmtim apo anormalitet i tyre ndikon në funksionin e përcimit të tingullit duke sjellë për pasojë atë që quhet humbje e ndjeshmërisë së tingullit. Ky dëmtim i përcimit të tingullit, përmes veshit të jashtëm dhe të brendshëm, mund të vijë prej një morie shkaqesh, nga trashëgimia ose jo, mund të ndodhë para lindjes ose më pas. Gjithsesi, zakonisht është rezultat i pengesave që krijohen në veshin e jashtëm ose të mesëm për shkak të keqformimeve, dyllit të krijuar, objekteve në vesh, lëngjeve, tumoreve, problemeve të kockave, infeksioneve, inflamacioneve etj. Ky pengim parandalon që tingulli të arrijë në veshin e brendshëm apo e dobëson atë. Humbja e dëgjimit përcjellës, në varësi të rastit, mund të trajtohet me ndërhyrje kirurgjikale ose me medikamente.

2.3.2 Humbjet neurosensoriale

Kanë të bëjnë me çrregullimet a dëmtimet në veshin e brendshëm dhe konkretisht në kërmillin (cochlea), me nervin auditor që përcjellin pulset në zonën kortikale të të dëgjuarit ose me të dyja njëkohësisht. Në këtë lloj humbjeje nuk kemi vetëm rënie të ndjeshmërisë së të dëgjuarit por edhe shtrembërim (deformim) të tingujve gjë që sjell dëgjim jo të qartë të të folurit nga ana e dëgjuesit. Kjo lloj humbjeje e të dëgjuarit mund të jetë kongenitale (para lindjes) ose mund të ndodhë më pas. Ajo mund të jetë rezultat i faktorëve gjenetikë (trashëgimia), infeksioneve (para, gjatë dhe pas lindjes), anormaliteteve zhvillimore apo faktorëve mjedisorë dhe traumatikë . Ekspozimi ndaj tingujve më të lartë se 85 decibel (dB) mund të dëmtojnë qelizat nervore (qimet). Humbjet neurosensoriale lidhen edhe me moshën por nuk mund të thuhet se eksperiencë me humbje të të dëgjuarit edhe me dëmtime 30–50% të këtyre qelizave. Në shumicën e rasteve ato nuk mund të korrektohen me ndërhyrje kirurgjikale apo medikamente por mund të ndërhyhet me përdorimin e paisjeve të përforcimit të të dëgjuarit .

2.3.3 Humbjet mikse

Përfaqësojnë ekzistencën njëkohësisht, tek i njejt person të të dy llojeve të mësipërme të humbjeve, përçuese dhe neurosensoriale. Çrregullimet qendrore: Kanë të bëjnë me disfunktion të sistemit nervor qendror dëgjimor shkaktuar nga një dëmtim a plagë në rrugët dëgjimore pranë pjesës dëgjimore kortikale ose në

vetëpjesën dëgjimore kortikale. Impulset e marra përmes nervit dëgjimor procesohen dhe interpretohen në këtë zonë. Një person me këto çrregullime mund të dëgjojë, por ka vështirësi kur në sfond ka zhurma, vështirësi në të dalluarit e zërave të fëmijëve dhe të femrave, me tingujt e lartë, me tingujt e mbytur, dëgjon zhurma në formë zillesh pareshtur etj. Një dëgjues me këto problematika mund të jetë i aftë të dëgjojë por gjërat nuk bëjnë sens apo nuk kuptohen nga ai. Këto lloj çrregullimesh të të dëgjuarit mund të bashkëshoqërohen me humbjet e sipërpërmendura të të dëgjuarit. Stach (2010), këtij lloj dëmtimi i referohej si “çrregullim i procesimit dëgjimor qendror” .

2.3.4 Çrregullimet qëndrore

Kanë të bëjë me disfunktion të sistemit nervor qendror dëgjimor shkaktoar nga një dëmtim a plagë në rrugët dëgjimore pranë pjesës dëgjimore kortikale ose në vetëpjesën dëgjimore kortikale. Impulset e marra përmes nervit dëgjimor procesohen dhe interpretohen në këtë zonë. Një person me këto çrregullime mund të dëgjojë, por ka vështirësi kur në sfond ka zhurma, vështirësi në të dalluarit e zërave të fëmijëve dhe të femrave, me tingujt e lartë, me tingujt e mbytur, dëgjon zhurma në formë zillesh pareshtur etj. Një dëgjues me këto problematika mund të jetë i aftë të dëgjojë por gjërat nuk bëjnë sens apo nuk kuptohen nga ai. Këto lloj çrregullimesh të të dëgjuarit mund të bashkëshoqërohen me humbjet e sipërpërmendura të të dëgjuarit. Stach (2010), këtij lloj dëmtimi i referohej si “çrregullim i procesimit dëgjimor qendror” .

2.4 Përkufizimi i dëmtimit dëgjimor

Termi dëmtim, i perceptuar si i tillë që nënkupton mangësi, tingëllon disi i rëndë për individët përkatës por edhe më gjerë. Gjithsesi, meqenëse ai vazhdon të përdoret gjerësisht në literaturë, midis specialistëve si edhe kudo në bazën ligjore, për të përshkruar pikërisht këtë kategori paaftësie, edhe ne jemi të detyruar ta përdorim po këtë term. “Dëmtimi dëgjimor” është term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar çrregullime të të dëgjuarit që variojnë që nga humbjet e lehta të të dëgjuarit deri tek humbjet e rënda apo në humbje a mungesë të plotë të tij (shurdhëri). Lidhur me përcaktimin e dëmtimit dëgjimor, për të krijuar një ide më të qartë, le ti referohemi disa përkufizimeve të ndryshme:

- Organizata Botërore e Shëndetit përcakton dëmtimin e dëgjimit si më poshtë:

Rënia e dëgjimit është një term i gjerë që përdoret për të përshkruar humbjen e dëgjimit në njërin ose në të dy veshët. Ekzistojnë nivele të ndryshme të dëmtimit të dëgjimit:

- Dëmtimi i dëgjimit i referohet humbjes së plotë ose të pjesshme të aftësisë për të dëgjuar nga njëri ose nga të dy veshët. Niveli i dëmtimit, për nevoja praktike, shpesh mund të vlerësohet si i butë, i moderuar, i rëndë ose i thellë;

- Shurdhëria i referohet humbjes së plotë të aftësisë për të dëgjuar nga njëri ose nga të dy veshët.
- Drejtoria e përgjithshme për shëndetin dhe konsumatorët e Komitetit Europian (BE), lidhur me përkufizimin dhe vlerësimin e dëmtimeve dëgjimore shprehet:
“Dëmtimi dëgjimor përcaktohet si i tillë që ka të bëjë me një reduktim/dobësim në saktësinë ose ndjeshmërinë e të dëgjuarit apo prezencën e përherëshme të zhurmave/ tingujve në vesh. Ai lidhet parësisht me aftësinë e individit të dëmtuar për të dëgjuar tinguj në një nivel të caktuar”.
- Ligji Federal (USA) “The Education of the Handicapped Act (P.L. 94-142):
Ky ligj përdor termin “dëmtimin dëgjimor” si një term të përgjithshëm që përshkruan një rrang të gjerë të humbjes së të dëgjuarit, përfshirë edhe shurdhërinë, ndërkohë që më tej i trajton ato ndarazi.
 - Rënia e dëgjimit përkufizohet si "një dëmtim në të dëgjuar, i përherëshëm apo me luhatje, që ndikon negativisht në performancën arsimore të një fëmije".
 - Shurdhëria përkufizohet si "një dëmtim i dëgjimit aq i rëndë sa fëmija është i dëmtuar në përpunimin e informacionit gjuhësor përmes dëgjimit, me ose pa amplifikim."
- Frisina (1974):
Pak a shumë në këtë linjë janë dhe autorë të tjerë mes të cilëve po i referohemi Frisina-s:
 - Një person i shurdhër është ai, të dëgjuarit e të cilit është i paaftë në atë shkallë, sa e bën të pamundur të kuptuarit e të folurit vetëm me anë të veshit, me ose pa përdorimin e një mjeti të të dëgjuarit.
 - Një person me dëgjim të rëndë është ai, të dëgjuarit e të cilit është i paaftë në atë shkallë, sa e bën të vështirë por jo të pamundur të kuptuarit e të folurit vetëm me anë të veshit, me ose pa përdorimin e një mjeti të të dëgjuarit.

2.5 Matja dhe klasifikimi i dëmtimit dëgjimor

2.5.1 Matja (vlerësimi) i dëmtimit dëgjimor

Tingulli përhapet me anën e valëve dhe si i tillë ka parametrat e tij fizikë. Matja e të dëgjuarit i shërben vlerësimit të tij dhe nëse ka dëmtime, përcakton masën e humbjes së të dëgjuarit. Mbi këtë bazë, audiologu si profesionist certifikuar/ licensuar për këtë qëllim, jep konkluzionin nëse kemi të bëjmë me dëmtim dhe paaftësi apo jo. Është gjithashtu detyrë e tij të përcaktojë nëse humbja e të dëgjuarit, në varësi të rastit që paraqitet, duhet të trajtohet me medikamente, me ndërhyrje kirurgjikale dhe nëse do të duhet, çfarë paisjesh

mbështetëse (assistive technology) apo sisteme të tjera amplifikimi do të përdoren. Në interes të trajtesës sonë do ti referohemi dy parametrave të zërit, frekuenca dhe lartësia.


Frekuenca është numri i lëkundjeve të burimit të tingullit në njësinë e kohës dhe matet me Hertz (Hz). Frekuenca matet elektronikisht, me saktësi të lartë.

Intensiteti Si rregull intensiteti i valës përcaktohet si fuqia për njësi të fushës përkatëse. Në audiometri kjo fuqi “përkthehet” në presion të tingullit dhe matet me decibel (dB). I lidhur me këtë është parametri i quajtur prag i dëgjimit. Thënë ndryshe, pragu i dëgjimit përcaktohet nga fuqia më e vogël e tingullit që arrihet të kapet nga veshi dhe që për individë të ndryshëm është e ndryshme. Pikërisht mbi bazën e këtyre parametrave, përgjatë testit audimetrik për vlerësimin e të dëgjuarit të një individ, ndërtohet audiograma. Dëmtimet në dëgjim mund të ndodhin në njërin vesh ose në të dy veshët. Në diagramë vlerat e frekuencës paraqiten në aksin horizontal ndërsa pragu i dëgjimit në atë vertikal. Testimi realizohet duke paraqitur tonalitete të pastra në frekuencat 250 Hz, 500 Hz, 1 kHz, 2 kHz, 4 kHz, 6 kHz dhe 8 kHz në audiogram, e shkallëzuar në hapa me nga 5 dB. Sipas Berk (2013) shumica e tingujvenjërëzore shtrihen në diapazonin 125 – 8000 Hz me shumicën e energjisë në të folurit njerëzor të përqëndruar midis 500 dhe 3000 Hz.

Pragu i të dëgjuarit për një individ apo secilin vesh matet për secilën nga frekuencat e mësipërme dhe vendoset në aksin vertikal. Ai është përcaktuar si 0 dB mbi bazën e testimit të një kampioni njerëzish të moshave të reja. Është përgjithësisht e pranuar që pragu i dëgjimit që varion midis 0 dBHL dhe 20 dBHL, në të gjithë diapazonin e frekuencës së testuar, të konsiderohet “normal”. Kështu që çdo nivel i pragut dëgjimor të një individ, në cilindo nga frekuencat audimetrike të listuara më lart, mund të përbëjë një humbje dëgjimi në atë frekuencë, në një masë të caktuar, në varësi të faktit se sa do të jetë mbi normalen 20 dB.

Sipas *Bess&Humes*(2008) pjesa më e madhe e të folurit njerëzor shtrihet në diapazonin midis 40 dhe 60 dB të presionit të tingullit. Çdo tingull mbi nivelin e presionit prej 130 dB si për shembull një turbinë e madhe elektrike (145 dB), mund të jetë ekstremisht e dhimbshme dhe dëmtuese. Në diagramën shpjeguese të mëposhtme 2.2, në boshtin vertikal jepet lartësia/fortësia e zërit nga 0-120 dB ose ndryshe edhe vlerat e pragut të dëgjimit dhe në atë horizontal frekuenca nga 125-8000 Hz.

Siç shpjeguar edhe më lart, për njërin apo të dy veshët matet pragu i dëgjimit në dB për secilën nga frekuencat, 125, 250, 500, 1000 etj. deri në 8000 Hz. Zona e të dëgjuarit për të folurin normal i takon fashës nga 10 deri në 60 dB, zonë në të cilën, në diagramë, janë vendosur edhe shkronjat për arsye të tingujve përkatës. Veshi i cili e ka pragun e dëgjimit mbi 60 dB e ka të vështirë në mos të pamundur të kapë të folurit normal. Për frekuencën 250 Hz, zhurmën e motorsharrës e kap edhe veshi që e ka pragun e dëgjimit 100 dB (i cili nuk kap



tingujt më poshtë se 100 dB) ndërkohë që për veshin e pa dëmtuar kjo zhurmë është agresive. Zona e rrethuar me vijë të lakuar shtrihet vertikalisht midis 10 dhe 50 dB dhe horizontalisht midis 150 dhe afërsisht 7000 Hz dhe përfaqëson pothuaj të gjithë zonën e dëgjimit normal të të folurit njerëzor, nga një vesh pa humbje dëgjimi. Ndërkohë zona e rrethuar nga një elips ku ndodhen edhe germat k, f, s, th dhe një zog është zona me frekuencat përkatëse ku dëgjimi i tingujve përkatës, përfshirë cicërimat e zogjve, është shumë i këndshëm për veshin njerëzor. Ka disa lloje të vlerësimit të të dëgjuarit të cilat përfaqësojnë matje me procedura të ndryshme në kushte apo rrethana të ndryshme (air-conduction audiometry, bone-conduction audiometry, play audiometry, speech audiometry, speech recognition audiometry. Është detyrë e audiologut të vendosë se çfarë dhe si do të bëjë matjet, sipas rastit që i paraqitet, për të mbërritur në rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

2.6 Klasifikimi i dëmtimit dëgjimor

Në literaturë hasen klasifikime të ndryshme mbi dëmtimet dëgjimore, gjithmonë referuar pragut të dëgjimit. E përbashkët është se pothuaj në të gjithë rastet përcaktohen fashat e mëposhtme:

- Pa dëmtim
- Dëmtim i lehtë / butë
- Dëmtim i moderuar
- Dëmtim i ashpër
- Dëmtim i thellë përfshirë shurdhërinë

Ndryshimet qëndrojnë në lëvizje të vogla në përcaktimin e kufinjve midis këtyre fashave. Organizata Botërore e Shëndetësisë, në tetor 2019, në buletin e saj ka publikuar një material mbi shkallët e humbjes së të dëgjuarit dhe klasifikimin ndërkombëtar të të funksionuarit, paaftësisë dhe shëndetit , klasifikim të cilin po e japim në tabelën e mëposhtme 2.3

Shkalla e dëmtimit	Vlerat audiometrike përkatëse (ISO) – dB	Performanca	Rekomandime	Komente shtesë nga klasifikimi i mëparshëm
0 Nuk ka dëmtim	25 dB ose më pak	Asnjë ose probleme dëgjimore të vogla. I aftë të dëgjojë pëshpëritjet	Ska	Rekomandohet edhe kufiri 20 dB. Individë me prag 15-20 dB mund të hasin probleme dëgjimore. Individë me humbje vetëmnë njerin vesh mund të hasin probleme dëgjimore edhe pse veshi tjetër është normal
1 Dëmtim i lehtë / butë	26 – 40 dB	I aftë të dëgjojë dhe përsëritë fjalët e dëgjuara të zërit normal në një metër distancë	Konsulencë. Mund të nevoiten paisje ndihmëse të të dëgjuarit	Ka disa vështirësi në të dëgjuar por zakonisht dëgjon nivelin normal të bisedës
2 Dëmtim i moderuar	41 – 60 dB	I aftë të dëgjojë dhe përsërisë fjalë kur përdoret zë i lartë në një metër distancë	Zakonisht rekomandohet përdorimi paisjeve ndihmëse të të dëgjuarit	Asnjë
3 Dëmtim i ashpër	61 – 80 dB	I aftë të dëgjojë disa fjalë kur i bërtitet në veshin më të mirë	Nevoiten paisje ndihmëse të të dëgjuarit. Nëqoftëse nuk ka të tilla në dispozicion, duhet të mësohet leximi i buzëve	Duhet të vihet në dukje mospërputhja midis pragut me tone të pastra dhe shkallës së aftësisë dalluese të folurit
4 Dëmtim i thellë përfshirë shurdhërimin	81 dB e lart	I pa aftë të dëgjojë dhe kuptojë edhe kur i bërtet	Paisjet të të dëgjuarit mund të ndihmojnë në të kuptuarit e fjalëve. Nevoitet rehabilitim shtesë. Leximi i buzëve dhe gjuha e shenjave janë thelbësore	Gjuha e folur e shtrembëruar, shkalla varet nga moshën në të cilën është humbur dëgjimi

2.7 Mjediset dhe kushtet sfiduese sipas shkallës së humbjes

Mjediset e ndryshme, vendosjet dhe mënyrat specifike të komunikimit me bashkëbiseduesit mund të jenë më pak apo më shumë sfiduese në varësi të shkallës së humbjes së dëgjimit. Njohja e këtyre sfidave është domosdoshmëri për të krijuar kushte mjedisore dhe modele komunikimi sa më të favorshme. Përvojat tashmë kanë krijuar një panoramë të kënaqshme të tyre - Richard M. Gargulio (2015), William L. Heward, Michael D. Orlansky, Turku A. (2012), etj.

2.8 Humbje e butë deri në të moderuar

Nxënësit që i takojnë kësaj fashe dëmtimi të të dëgjuarit, komunikojnë me anë të të dëgjuarit dhe të folurit. Në disa situata apo në disa mjedise ato nuk hasin vështirësi të mëdha në të dëgjuar dhe për pasojë komunikojnë lehtësisht. Të njëjtët individë, në disa situata të tjera hasin vështirësi dhe si të thuash, janë të sfiduar në komunikimin e tyre. Ndër situatat dhe mjediste sfiduese mund të përmenden:

- Zhurma në sfond nga makineritë si matrapik, fshesë me korent, frigoriferi, lavatriçe etj.
- Zhurma në sfond nga trafiku i makinave apo ai ajror (afër aeroporteve), era që fryn, fabrikat, punimet në mjedise të brendëshme e të jashtme etj.
- Zhurma nga muzika e lartë, bisedat e njerëzve në koridore, rrugë, kafene, stadione, grumbullime të ndryshme etj.
- Përdorimi i disa telefonave, veçanërisht celularët.
- Tingujt e alarmeve me frekuenca të larta, burime të tjera të ngjashme tingujsh.
- Mjedise që kërkojnë heqjen e paisjeve në ndihmë të të dëgjuarit dhe vendosje paisjesh mbrojtëse si kufje etj.
- Mjedise si klasat, mbledhjet ku nuk ka mikrofone dhe zëri nuk dëgjohej etj.

2.9 Humbje e ashpër deri në të thellë

Nxënësi i kësaj fashe dëgjimore e merr informacionin vizualisht dhe si mjet komunikimi përdor të folurit. Informacioni pamor, siç e shpjeguem edhe më lart, për këta nxënës është i domosdoshëm për të kuptuar në mënyrë korrekte atë çka thuhet. Nëse fëmija do të kishte lindur i shurdhër, si rregull, kjo nuk do të funksiononte. Kjo është e vlefshme për ata që kanë vendosur paisje ndihmëse

me operacion (choclear implant) apo për ata që kanë shurdhëri pasgjuhësore (kanë lindur me dëgjim dhe e kanë humbur atë pas mësimit të gjuhës apo diçka e ndërmjetme). Veç sa edhe për humbjen e butw dhe të moderuar, situata a mjedise sfiduese shtesë për to janë edhe:

- Bisedat telefonike, pa përjashtim.
- Videot mësimore pa titra.
- Emissionet televizive, lajmet a filmat pa titra apo pa u shoqruar me gjuhën e shenjave.
- Bisedat dyshe në mjediset shkollore apo të tjera të ngjashme.

2.10 Afër shurdhërisë apo shurdhërisë së plotë

Nxënësi i kësaj fashe, si rregull, ka lindur i shurdhër apo e ka humbur shpejt të dëgjuarin, pa fituar qoftë edhe minimumin e aftësive të të folurit. Të tillë individë, për të realizuar komunikimin, kanë nevojë për përdorimin e gjuhës së shenjave. Ka prej tyre që mund të përdorin edhe të folurin (nëse me to është punuar mirë) por gjithsesi, si rregull, ato ndjehen më mirë me përdorimin e gjuhës së shenjave. Pothuaj të gjitha situatat dhe mjediset më parë, për to, janë sfiduese. Më ndryshe shfaqen individët të cilët e kanë humbur të dëgjuarin, pasi e kanë mësuar gjuhën të cilët gjithashtu përqëndrohen në leximin e buzëve dhe gjuhën e shenjave.



Kapitulli 3

Verbëria dhe humbja e shikimit

Dëmtimi i shikimit është i ndarë në tre kategori kryesore – shikim i dobët , verbëri funksionale / verbëri dhe dëmtimi i shikimit cerebral). Secili prej këtyre grupeve ka karakteristika specifike që do të bëjnë zgjedhjen e mjeteve të duhura ndihmëse.

3.1 Kufizimi i shikimit

- Shikimi dobët: Një gjendje okulare ku është shikueshmëria e një personi shkon nga 20/70 deri në 20/200 (ligjërisht i verbër) pas korrigjimit më të mirë, ose fushës së shikimit i nënshtrohet këndit prej 50 gradë ose më pak.
- Verbëri funksionale / verbëri: Një gjendje okulare ku një person perception dritë ose më pak, ose nuk është në gjendje të përdorë me efikasitet shikimin e mbetur.
- Dëmtimi /rënia e shikimit cerebral: Një gjendje neurologjike që lidhet me rrugën e shikimit ku një person ka vështirësi në interpretimin e informacionit

3.2 Përdorimi i procesit SETT dhe udhëzues për vendimmarrje

Procesi SETT është krijuar për të përcaktuar ato karakteristika në mënyrë që të rekomandojë zgjedhjen më të mirën të mundshme. Procesi SETT merr në konsideratë disa faktorë që ndikojnë në zgjedhjen e mjeteve, pajisjeve dhe ndërhyrjeve. Është e domosdoshme që pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit të jenë njohur. Vlerësimi i nevojave merr në konsideratë edhe mjedisin në të

cilin nxënësi merr udhëzimin. Është gjithashtu e rëndësishme të kemi qasje informuese për planet e nxënësve pas mbarimit të shkollës së mesme. Kur të mblidhen të gjitha informacionet e mësipërme, mund të merren vendime përfundimtare. Vlen të përmendet që në disa raste mund të zbatohen më shumë se një zgjidhje për të arritur rezultatet e dëshiruara. Procesi i vendimmarrjes në lidhje me teknologjinë ndihmëse mund të jetë kompleks dhe i pasaktë, duke e bërë të vështirë përputhjen e një mjeti me një zonë specifike. Për shembull, për t'i dhënë një nxënësi me shikim të dobët një mundësi për të shtypur, një libër të madh, ose normal, i sigurohet një zmadhues për ta arritur atë.

3.2.1 Aftësitë vështirësitë e nxënësve

A mundet që nxënësi të lexojë rregullisht? Nxënësit me shikim të ulët dhe dëmtime vizuale cerebrale mund të kërkojnë ndryshim në madhësinë e shkrimit/printimit dhe tipit. Të gjitha ndryshimet do të varen nga gjendja e shikimit të nxënësve dhe preferencat e tyre dhe duhet të dorëzohen përmes vlerësimit, vlerësimit funksional të shikimit dhe / ose vlerësimit të të nxënit.

Cilat janë fushat më të efektshme të leximit për nxënësit? Fusha e leximit është shumë e rëndësishme. Disa nxënës mund të përdorin një kombinim të fushave — vizuale, prekëse, audio ose elektronike (e-teksti) për të përmirësuar ose mbështetur leximin parësor. Mësuesit AT (mësuesit e teknologjisë ndihmëse) të personave me aftësi të kufizuara do të përcaktojnë se cilat fusha do të jenë më së shumti funksionale në lexim.

A mund të kuptojë nxënësi informacionin me anë të një pikturë? Kur nxënësit me shikim të ulët duhet të bashkëveprojnë me informacionin e pikturuar, ata mund të kenë nevojë për disa lloje të zmadhimit. Materiali i zgjeruar mund të jetë i mjaftueshëm për disa nxënës. Të tjerët do të kenë nevojë për mjete optike ose elektronike të zmadhimit. Nevojat e zmadhimit përcaktohen përmes shikimit të ulët nga vlerësimi klinik.

A është e lexueshme shtypja, shkrimi i një nxënësi? Shkrimi mund të jetë problematik për shkak të shikimit të dobët dhe koordinimit të syrit me dorën. Disa nxënës me shikim të ulët mund të jetë në gjendje të shkruajnë, por forma dhe madhësia e shkronjave mund ta bëjnë shkrimin e dorës të palexueshëm. Në raste të tilla, në qoftë se nxënësi nuk është një përdorues i Braille, shtypja duhet të merret në konsideratë.

A mundet një nxënës të shtyp, shkruaj? Shtypja është një nga aftësitë më thelbësore që lejon komunikimin me shkrim. Një kompjuter ose pajisje të tjera mund të ofrojnë çelësa të kontrastit të mëdha dhe të larta për të shtypur, por për të qenë një tipograf efektiv, prekja duhet të konsiderohet si një zgjidhje afatgjatë.

A mundet që nxënësi të lundrojë në mënyrë të pavarur në sistemin kompjuterik? Nxënësit me dëmtim të shikimit do të kërkojnë lloje të ndryshme të mundësive të sistemit operativ për të kryer detyra të bazuara në kompjuter. Për disa, veçoritë e integruara të aksesit do të mjaftojnë, ndërsa të tjerët do të kenë nevojë për programe me të specializuara.

A është nxënësi fotofobik (jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj dritës)? Nxënësit që janë shumë të ndjeshëm ndaj dritës mund të kërkojnë mjete që u lejojnë atyre të rregullojnë skemat e ngjyrave. Për më tepër, duhet të merren parasysh studentët që kanë probleme me ngjyrat. Materiali mësimor mund të duhet gjithashtu të sigurohet në kombinimin e preferuar të ngjyrave për të zvogëluar ndicimin dhe përmirësuar kontrastin.

A mund të marrë pjesë nxënësi në aktivitete sportive në palestër? Shumë lojëra në palestër përfshijnë përdorimin e një topi. Në varësi të sportit të luajtur topat ndryshojnë në madhësi dhe peshë. Nxënësit me dëmtim të shikimit mund të kërkojnë mjete të adaptuara në palestër. Mënyrat si lojrat luhen gjithashtu mund të modifikohen për të përfshirë nxënësit me probleme të shikimit.

Cilat janë aftësitë organizuese të nxënësit? Mbajtja në mënyrë të rregullt e sendeve është një aftësi veçanërisht e rëndësishme për një nxënë me dëmtim të shikimit. Shumë nxënës, veçanërisht të rinj, kanë nevojë për ndihmë për të mësuar për të mbajtur materialet/sendet e tyre në rregull. Duhet të jetë një pjesë e vazhdueshme e udhëzimit për mësimin e vendosjes së sendeve në vendin e duhur.

Çfarë sfidash motorike ka një nxënësi? E rëndësishme është të përcaktohet nëse ka ndonjë çështje tjetër fizike ose të lidhur me të që të merret në konsideratë. Disa dëmtime motorike mund të ndikojnë në aftësinë e një nxënësi për të bashkëvepruar me Braille ose lundrojnë në mjedisin e tyre në mënyrë efektive.

Ku duhet të përqendrohet një nxënësi në Kurrikulën bazë të zgjeruar? Nxënësit me dëmtim të shikimit duhet të marrin pjesë në një kurrikul bazë të zgjeruar që përfshin përdorimin e disa aftësive si aftësinë kompensuese, orientimin dhe lëvizshmërinë, aftësinë e bashkëveprimit shoqëror, aftësinë e të qenit i pavarur, e drejtimit dhe organizimit të jetës, aftësinë rekreative dhe të kohës së lirë, aftësinë për zhvillimin profesional dhe karrierën, efkasitet vizual dhe nevojën për përdorimin e teknologjisë ndihmëse. Aftësitë kompensuese përfshijnë përdorimin e mjeteve, përshtatjeve, modifikimeve dhe sjelljeve që rrisin mundësinë e nxënësit për të hyrë në një mjedis, informacione për aktivitetet edukative dhe nevojat themelore të njeriut. Kjo mund të përfshijë një larmi mjetesh komunikimi, lexim dhe shkrim të përshtatur mjete organizimi dhe numërimi.

A mund të marrë pjesë nxënësi në aktivitete jashtë-kurrikulare? Në shumicën e rasteve nxënësi mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme pasi shumë sporte janë plotësisht të arritshme për një nxënës me dëmtime në shikim, siç janë mundje, not, atletikë dhe sporte të tjera. Për një nxënës me dëmtime të mëdha ose verbëri përshtatjet mund të krijohen për të treguar vendndodhjen ose destinacionin. Sporte që përdorin një top ose një objekt, Lëvizjet mund të kenë nevojë të përdorin një top me ngjyra dhe kontrast të lartë, formë më të madhe ose më të butë, ose ndonjë lloj të mekanizmit të shëndoshë për të ndihmuar nxënësin ta lokalizojë atë. Për shumë aktivitete jo atletike nuk mund të nevojiten pajisje të posaçme, siç është klubi i debatit ose ai gjuhësor. Disa aktivitete mund të kërkojnë kujdes ndaj vendndodhjes dhe/ose destinacionit. Materiale mund të kërkojnë përshtatje me fushën e duhur siç janë Braille ose formatet audio të informacionit të nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë efektive.

Rëndësia e shqisave Mjedise të ndryshme kanë nivele të ndryshme të stimulimit shqisor nëse ekipi është i vendosur që ndikimet ndijore janë me ndikim për nxënësit që mësojnë të identifikojnë nivelin ndijor që ka në secilin mjedis ku do të jetë nxënësi. Përballja me zhurmën mjedisore është një fakt i jetës. Nëse një nxënës është i hutuar nga zhurmat në sfond, ata mund të kenë nevojë të mësojnë strategji përballimi ose të kenë mjedis të modifikuar pasi mësojnë se si të japin përparësi tingujve rreth tyre.

Rëndësia e mjedisit (hapësirës) Hapësira për tavolinë Për punën e nxënësve me aftësi ndryshe kërkohet hapësirë e bollshme e tavolinës për shkak të madhësisë së materialit dhe mjeteve mbështetëse. Ajo hapësirë është e domosdoshme jo vetëm për t'iu përshtatur të gjitha materialeve dhe mjeteve, por edhe për t'i ndihmuar nxënësit të organizohen. Nëse hapësira e mjaftueshme nuk mund të ofrohet, atëherë mjetet që zënë më pak hapësirë, por plotësojnë kërkesa specifike do të konsiderohen parësore.

Hapësira në klasë Hapësira në klasë është gjithashtu thelbësore në mënyrë që nxënësit të lëvizin lirshëm pa shumë pengesa. Disa nxënës, pavarësisht se janë ulur në klasë, mund t'ju duhet të shkojnë deri te dërrasa e zezë ose do të duan të marrin shërbime të tjera. Ky ndryshim i paraqitjes së nxënësit në tabelë kërkon një pastrim të rrugës që ai të marrë informacionin apo shërbimin e kërkuar.

Vendndodhja Vendndodhja e pajisjeve të duhura gjithashtu mund të ndikojë në zgjedhjet. Nxënësi me shikim të ulët mund të ulët përpara, që do të thotë se një CCTV mund të jetë në pozicion të dukshëm për këta nxënës dhe të tjerët të jenë ulur pas.

Qasja vizuale e prezantimeve në klasë Prezantimet në grupe të mëdha dhe puna me tastjerwn mund të jenë të paarrtshme për nxënësit me dëmtime

të shikimit pa mjete hyrëse të krijuar posaçërisht për ata. Nxënësit mund të kërkojnë kopje të desktopit. Në disa raste një lloj tjetër tastjere mund të rrisë qasjen vizuale të nxënësit.

Lloji i dritës dhe niveli i ndriçimit Lloji i dritës dhe niveli i ndriçimit do të përcaktojë gjithashtu se ku mund të ulet nxënësi. Disa nxënës mund të kërkojnë dritë të zbehtë, ndërsa të tjerë mund të kenë nevojë për nivel më të lartë të ndriçimit. Nëse nxënësit duhet të rregullojnë individualisht nivelin e dritës, mund të kenë nevojë për një dritë tryeze, kështu që tavolina e tyre duhet të pozicionohet pranë një prizë energjie.

Lloji i fushës së të nxënës Vendosja pranë një prize të energjisë do të jetë gjithashtu e nevojshme kur nxënësit punojnë me mjete të ndryshme elektronike. Shumë pajisje moderne kanë bateri të rikarikueshme, por koha e funksionimit të tyre zakonisht është dy ose tre orë. Prandaj nxënësit do të duhet të futin pajisjet e tyre një ose dy herë në ditë brenda për të rimbushur bateritë. Disa nga kompjuterët e rinj kanë jetë më të gjatë të baterisë, por problemi është që ekrani mund të mos jetë mjaft i ndritshëm për një student me dëmtime në shikim.

Zhurmat e jashtme Meqenëse nxënësit me dëmtim të shikimit, veçanërisht ata me shikim të ulët /të dobët ose verbëri, mbështeten te dëgjimi i tyre për të mbledhur informacion gjatë orëve të mësimi, është e rëndësishme të sigurohet që ndonjë nga zhurmat e panevojshme të jashtme të eliminohen ose zvogëlohen.



Kapitulli 4

Teknologjia ndihmëse

Aftësitë e kufizuara të fëmijëve janë sfidë e jashtëzakonshme për prindërit, mësuesit dhe gjithë shoqërinë tonë, ku të gjithë së bashku duhet të luftojnë për përbalimin e saj. Në këtë kontekst, të gjithë këta aktorë duhet të bashkëpunojnë për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për ta lehtësuar atë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe teknologjisë së dizenuara për këtë qëllim. Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre, të përçojnë mesazhin që ata kanë për bashkëbiseduesit, të bëjnë të ditura nevojat apo dëshirat që ata kanë, si dhe të shprehin emocionet e tyre tek të tjerët. Në këtë mënyrë, me gjithë pengesat e mundshme në komunikim, idetë e tyre do të kenë një zë. Ky zë mund të jetë përmes pajisjeve teknologjike ndihmëse.

Si i ndihmon teknologjia fëmijët me nevoja të veçanta Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është në rritje sipas studimeve të fundit. Për shkak të shumëllojshmërisë së lartë të llojeve të aftësive të kufizuara, rezultati më i mirë i mundshëm mund të garantohet me përdorimin e zgjidhjeve të bëra me porosi, të hartuara sipas kërkesave të një grupi të veçantë studentësh.

“Teknologjia ndihmëse në edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, paraqitet si një pasuri e informacionit praktik, të mirëorganizuar për të ndihmuar familjet, mësuesit dhe terapistët të gjejnë zgjidhje efektive për studentët me mësim, shkrim leximi dhe sfida njohëse. Paraqitja e mjeteve të reja të përballueshme për të përmirësuar dhe kompensuar sfidat që lidhen me të folurit, të kuptuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të menduarit dhe të kujtuarit, si dhe strategji për të ndihmuar studentët të bëhen më të organizuar dhe më efikas”

Teknologjia për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta lejon rritjen e pavarësisë së një nxënisi të veçantë duke e çliruar atë nga nevoja e vazhdueshme për përfshirje të drejtpërdrejtë të mësuesve. Si rezultat, një nxwnws mund të zgjedhë shpejtësinë e të mësuarit që është i përshtatshëm për të dhe çon në mësim më të personalizuar. Kur një nxwnws nuk e pengon procesin e të mësuarit për të gjithë grupin, ai lejon uljen e niveleve të ankthit, i

cili luan një rol të rëndësishëm edhe në arsim. Zbatimi i teknologjive në arsimin special lejon thjeshtimin e komunikimit dhe përmirësimin e aftësive akademike të studentëve me aftësi të kufizuara.

“Teknologjia bën të mundur që një klasë të përmirësohet me ngjarje individuale të të nxënit, duke lejuar instruktorët të ofrojnë një fleksibilitet dhe diferencim më të madh në udhëzime. Mësuesit mund të përdorin teknologjinë për të ofruar një shumëllojshmëri të mundësive mësimore dhe qasjeve që përfshijnë, udhëzojnë dhe mbështesin studentët e arsimit special me një numër taktikash të dizajnuara për t’u tërhequr nxënësve individualë. Studentët nuk janë më të mbërthyer në një klasë që nuk e kuptojnë, duke u përpjekur të mësojnë me një ritëm që nuk mund të vazhdojnë me të ose të marrin pjesë në të. ”

Sipas Sullivan ‘teknologjinë ndihmëse’ është: "çdo send, pjesë a pajisjeve qoftë i hedhur në treg, i modifikuar ose përshtatur, që përdoret për të rritur, mirëmbajtur ose përmirësuar aftësitë funksionale të individëve me aftësi të kufizuara". Ajo përfshin një larmi të gjerë mjetesh joteknologjike, të teknologjisë së ulët dhe teknologjisë së lartë. Mjete ndihmëse klasifikohen në tri kategori:

- Pajisje jo teknologjike, ku përfshihen: mbajtëse lapsi, shënime të ngjitura, fletë me vija të gatshme, sipërfaqe të pjerrta, shiritat me ngjyra, shkronja të prekshme, shirita zmadhues etj
- Teknologji e ulët, ku përfshihen: zile apo drita, makinë llogaritëse me zë, MP3 player, organizues elektronik etj.
- Teknologji e lartë, ku përfshihen: lexues elektronik, pajisje elektronike me ekran të prekshëm, testimet kompjuterike, programe kompjuterike që komandohen me zë, kthimi i librit (tekstit) në zë etj.

Disa nga mjetet ndihmëse janë:

- Ndihma lëvizëse, të tilla, si: karriget me rrota, skuterat, mbështetëset e këmbësorëve, kallamarët, patericat, pajisjet protetike dhe pajisjet ortopedike.
- Ndihma dëgjimi për të ndihmuar njerëzit të dëgjojnë më qartë.
- Ndihmat konjitive, përfshirë kompjuterin ose pajisjet ndihmëse elektrike, për të ndihmuar njerëzit me kujtesën, vëmendjen ose sfida të tjera në aftësitë e tyre të menduarit.
- Programe kompjuterike dhe pajisje kompjuterike, të tilla si programet e njohjes së zërit, lexuesit e ekraneve dhe aplikacionet për zgjerimin e ekranit, për të ndihmuar njerëzit me lëvizshmëri dhe dëmtimet shqisore të përdorin kompjuterë dhe pajisje të lëvizshme.
- Mjete të tilla, si: kthyeset automatike të faqeve, mbajtësit e librave dhe rripat e përshtatur me laps për të ndihmuar nxënësit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në aktivitete arsimore.

- Qarqet e mbyllur për të lejuar njerëzit me probleme të dëgjimit të shikojnë filma, programe televizive dhe medie të tjera digjitale.
- Modifikimet fizike në mjedisin e ndërtuar, përfshirë rampet, shufrat e rrëmbyeshme dhe dyert më të gjera për të mundësuar hyrjen në ndërtesa, biznese dhe vende pune.
- Pajisjet e lehta të lëvizjes me performancë të lartë që mundësojnë që personat me aftësi të kufizuara të luajnë sport dhe të jenë aktiv fizikisht.
- Pajisje adaptuese dhe veglat për të lejuar ata që kanë aftësi të kufizuara motorike të hanë, të luajnë lojëra dhe të kryejnë veprimtari të tjera.
- Pajisjet për të ndihmuar në kryerjen e detyrave të tilla, si: gatimi, veshja dhe veprimtaritë e përditshme; dorezat e specializuara, pajisjet që shtrihen, dritat në telefona dhe shiritat e dyerve.

4.1 Teknologjia ndihmëse për dëmtimet dëgjimore

Teknologjia ndihmëse (Assistive Technology) nënkupton pajisjet që shërbejnë për të ndihmuar të dëgjuarin dhe mbështetur komunikimin. Teknologjia mbështetëse mund të përmirësojë në mënyrë rrenjësore jetën e individëve me humbje të dëgjimit. Sistemet ndihmëse të të dëgjuarit përfaqësojnë ura që mundësojnë kapërcimin e “hendekut” midis individit dhe burimit të tingullit duke eliminuar efektin e distancës, të zhurmave të mjedisit a sfondit dhe jehonat. Çdo mjete ose shërbim përshtatës që rrit pjesëmarrjen, arritjet dhe pavarësinë për një nxënës me paaftësi, duhet të konsiderohet teknologji ndihmëse. Teknologjia mund të jetë e nivelit të ulët dhe si rregull më e lehtë për tu përdorur ndërsa sistemet e teknologjisë së lartë rrokin një rrang të gjerë nivelesh të ndryshme dhe janë më komplekse. Për të bërë paraqitjen e teknologjisë ndihmëse e kemi parë më e përshtatëshme jo thjeshtë ti rendisim por ti paraqisim në përputhje me rastet kur përdoren, sipas nivelit të humbjes. Për këtë qëllim po i formatojmë në tabelat e mëposhtme 4.14.24.3:

4.1.1 Humbja e butë deri në të moderuar

Në këtë rast duhet të dijmë nëse nxënësi përdor aktualisht nxënësi pajisje ndihmëse dhe nëse pajisja e tij ka tele-coil?

Nr	Situatat ku ndodhet nxënësi	Mjete ndihmëse që duhet të përdoren	Cilat janë këto mjete
1	<ul style="list-style-type: none"> Mjedise me zhurma Grupe të vegjël bashkëbiseduesish Mjedise që kërkojnë zë të ulët Mjedise që kërkojnë heqje të paisjeve të të dëgjuarit 	Mjete të të dëgjuarit me adresim drejtëpërsëdrejti tek folësi dhe me reduktim të zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> Mjete personale të të dëgjuarit (më pak kosto) Sistemet FM (më të shtrenjta por më efçiente)
2	<ul style="list-style-type: none"> Mbledhje a takime me numur të madh nxënësish a njerëzish Mësimi në klasë 	Kërkon që folësi të përdorë mikrofonin gjithë kohën	<ul style="list-style-type: none"> Sistemet FM Laku induksionit (induction loop) Sistemi infrared i të dëgjuarit
3	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim telefoni të zakonshëm 	Mjete që përforcojnë(amplifikojnë) volumin e ziles dhe zërit	<ul style="list-style-type: none"> Përshtatës telefonik Amplifikues i zërit
4	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim telefonicelular 	Mjete që amplifikojnë	<ul style="list-style-type: none"> Amplifikues me induksion Amplifikues akustikë
5	<ul style="list-style-type: none"> Situata alarmi 	Mjete alarmi zanor	<ul style="list-style-type: none"> Orë alarmi (alarm clocks) Sistemet sinjalizuese (alerting systems)

Nr	Situatat ku ndodhet nxënësi	Mjete ndihmëse që duhet të përdoren	Cilat janë këto mjete
1	<ul style="list-style-type: none"> Mjedise me zhurma Grupe të vegjël bashkëbiseduesish Mjedise që kërkojnë zë të ulët 	Mjete të të dëgjuarit me adresim drejtëpërsëdrejti tek folësi dhe me reduktim të zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> Mjete personale të të dëgjuarit (më pak kosto) Sistemet FM (më të shtrenjta por më eficiente) Link-it Sistemi infrared i të dëgjuarit Marrës shënimesh (note taker)
2	<ul style="list-style-type: none"> Mbledhje a takime me numur të madh nxënësish a njerëzish Mësimi në klasë 	Mjete që kërkojnë përdorimin e mikrofonit nga folësi përgjatë gjithë kohës	<ul style="list-style-type: none"> Sistemet FM Laku induksionit (induction loop) Sistemi infrared i të dëgjuarit Marrës shënimesh (note taker) Paisjet me zë e figurë (Audisee – leximi i të folurit)
3	<p>Shikimi i TV</p> <p>Shikimi i video-ve</p> <p>Shikimi imedia - DVD</p>	Shfaqje e tekstit te shkruar në ekrane	<ul style="list-style-type: none"> Televizion Paisje me ekrane me përdorim titrash
4	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim telefoni të zakonshëm 	Mjete që përforcojnë (amplifikojnë) volumin e ziles dhe zërit	<ul style="list-style-type: none"> Përshtatës telefonik Amplifikues i zëri Amplifikues In-line Cap-Tel (tekst i shkruar i bisedës ne ekran) Voice Mail Transcription (mesazhi zanor ne tekst)
5	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim telefoni celular 	Mjete që amplifikojnë	<ul style="list-style-type: none"> Amplifikues me induksion Amplifikues akustikë
6	<ul style="list-style-type: none"> Situata alarmi 	Mjete alarmi zanor	<ul style="list-style-type: none"> Orë alarmi (alarm clocks) Sistemet sinjalizuese (alerting systems)

4.1.2 Dëmtim i moderuar deri në të ashpër

Në rastin e dëmtimit të moderuar, për përzgjedhjen e paisjeve ndihmëse për një nxënës, duhet të dijmë nëse ai përdor aktualisht paisje në ndihmë të të dëgjuarit apo nëse ka vendosur me operacion “cochelar implant”? Nëse ka paisje të tillë, është e llojit brenda veshit apo jashtë veshit dhe a kanë “telecoils” të instaluar?

Edhe në rastin e dëmtimit të ashpër, për përzgjedhjen e paisjeve ndihmëse për një nxënës, duhet të dimë nëse ai përdor aktualisht paisje në ndihmë të të dëgjuarit apo nëse ka vendosur me operacion “cochelar implant”? Nëse ka pajisje të tillë, është e llojit brenda veshit apo jashtë veshit dhe a kanë “telecoils” të instaluar? Më tej duhet të dimë se sa informacion merr nxënësi vizualisht dhe sa përmes të dëgjuarit. Nuk duhet të harrojmë se individët me dëmtime të ashpra të të dëgjuarit ndryshojnë konsiderueshëm nga njeri- tjetri për nga mënyra se si funksionojnë . Disa e përdorin në mënyrë më efektive përqindjen e të dëgjuarit që posedojnë e disa më pak. Në disa situata e kanë më lehtë të përdorin të dëgjuarit e për pasojë komunikimin e në disa jo.

Nr	Situatat ku ndodhet nxënësi	Mjetet ndihmëse që duhet të përdoren	Cilat janë këto mjete
1	<ul style="list-style-type: none"> Mjedise me zhurma Grupe të vegjël bashkëbiseduesish Mjedise që kërkojnë zë të ulët 	<p>Mjete të të dëgjuarit me adresim drejtëpërsëdrejti tek folësi dhe me reduktim të zhurmave.</p> <p>Telecoils në paisjet janë të rëndësishëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Mjete personale të të dëgjuarit (më pak kosto) Sistemet FM (më të shtrenjta por më eficiente) Link-it Sistemi infrarred i të dëgjuarit Mjete të folur –tekst i shkruar (Speech-to-Text Accommodations) Marrës shënimesh (note taker)
2	Komunikimi kokë më kokë	Mjete për të shkruar	<ul style="list-style-type: none"> Të shkruarit bashkëveprues (Interactive Writing) Letwr e laps a paisje elektrike me ekran
3	<ul style="list-style-type: none"> Mbledhje a takime me numur të madh nxënësish a njerëzish Mësimi në klasë 	Mjete që kërkojnë përdorimin e mikrofonit nga folësi përgjatë gjithë kohës	<ul style="list-style-type: none"> Sistemet FM Laku induksionit (induction loop) Sistemi infrarred i të dëgjuarit Marrës shënimesh (note taker) Mjete të folur –tekst i shkruar (Speech-to-Text Accommodations) Mjete me zë e figurë (Audisee – leximi i të folurit)
4	<ul style="list-style-type: none"> Shikimi I TV Shikimi i video-ve Shikimi i media - DVD Përdorim telefoni të zakonshëm 	Shfaqje e tekstit te shkruar në ekrane	<ul style="list-style-type: none"> Televizion Mjete me ekrane me përdorim titrash
		Mjete që përforcojnë (amplifikojnë) volumin e ziles dhe zërit	<ul style="list-style-type: none"> Përshtatës telefonik Amplifikues i zëri Amplifikues In-line Cap-Tel (tekst i shkruar i bisedës ne ekran) Voice Mail Transcription (mesazhi zanor ne tekst) TTY (Paisje për komunikim me tekst përmes telefonit)
5	Përdorim telefoni celular	Mjete që amplifikojnë	<ul style="list-style-type: none"> Amplifikues me induksion Amplifikues akustik TTY
6	Situata alarmi	Mjete alarmi zanor	<ul style="list-style-type: none"> Orë alarmi (alarm clocks) Sistemet sinjalizuese (alerting systems)



4.1.3 Dëmtim i ashpër deri në të thellë

Nr	Situatat ku ndodhet nxënësi	Mjete ndihmëse që duhet të përdoren	Cilat janë këto mjete
1	<ul style="list-style-type: none"> Mjedise me zhurma Grupe të vegjël bashkëbiseduesish 	Mjete për sigurim të informacionit në rrugë vizuale	<ul style="list-style-type: none"> Interpretues Mjete të folur –tekst i shkruar (Speech-to-Text Accommodations) Të shkruarit bashkëveprues (Interactive Writing) Gjuha e shenjave Marrës shënimesh (note taker) Mjete me zë e figurë (Audisee – leximi i të folurit)
2	<ul style="list-style-type: none"> Mbledhje a takime me numur të madh nxënësish a njerëzish Mësimi në klasë 	Në përshtatje me formën e gjuhës që preferohet	<ul style="list-style-type: none"> Interpretues Mjete të folur –tekst i shkruar (Speech-to-Text Accommodations) Marrës shënimesh (note taker)
3	<ul style="list-style-type: none"> Shikimi i TV Shikimi i video-ve Shikimi i media - DVD 	Shfaqje e tekstit të shkruar në ekrane, materiale videotrainuese	<ul style="list-style-type: none"> Televizion Pajisje me ekrane me përdorim titrash
